



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:235027
Datë: 13.03.2024
Numri i dokumentit: 05443493

C-IV-14-2689

Pala Ankuese: N K nga fshati B, Komuna e Kamenicës.

Kundër

Palës kundërshtare: Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Rr. “Dritan Hoxha”, nr. 55, Lakrishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtaren Ganimete Puka, me datë 23.02.2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

I: REFUZOHET e pabazuar ankesa e ankuesit N K nga fshati B, Komuna e Kamenicës, e paraqitur kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit nr. GJI045-0806, të datës 21.03.2014.

II: Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 11. Prill. 2014, ankuesi parashtroj ankesë për rishqyrtimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (tutje AL) nr. GJI045-0806, të datës 21.03.2014, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensim për paga të papaguara për periudhën Maj - korrik 2006, në shumë prej 3x300 = 900.00€ nga N.SH. “NHTT XIQ Karaqeva” (në likuidim). Ankuesi pretendon se sipas ligji 03/L-034, i takojnë tri paga të pa paguara që janë prioritete, dhe se ka qenë pjesë e listës së 20 % nga të ardhurat e privatizimit.

Me 06.02.2017, e pala kundërshtare në mbrojtjen e tij të parashtruar kundër ankesës, pohoi se i kundërshton të gjitha pretendimet e ankuesit të paraqitura në ankesë, duke i konsideruar si të pabazura në ligj. AKP pohoi se ankuesi nuk ka prezantuar fakte edhe në kuptim të nenit 7 të Ligjit mbi procedurën kontestimore ku theksohet se “palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla si dhe ashtu siç parasheh Ligji për Dhomën e Posaçme. E paditura ka theksuar se kërkesa

e ankuesit është edhe e parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në gazetën zyrtare RSFJ 53/1976), i cili parashikon se kërkesat e punëtorëve që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit parashkruhen, pas kalimit të afatit 3 vjeçar nga koha kur detyrimi është dashur ta përmbushet. I ka propozuar Gjykatës që ankesën e ankuesit ta refuzoj si të pabazuar dhe ta vërtetoj vendimin e AL-së.

Me 08.02.2017, gjykata i ka dorëzuar mbrojtjen e AKP-së tek ankuesi, në mënyrë që ai të praqes përgjigje ndaj mbrojtjes së AKP-së.

Me 13.09.2021, gjykata i ka dërguar ankuesi urdhër për të parashtrua prova shtese, për ti vërtetua lartësinë e pagave të kërkuar.

Me 24.09.2021, ankuesi ka paraqitur një parashtrësë për precizin të ankesë, dhe ka shtuara se kërkesa e ankuesit nuk është parashkruar dhe konsideron se vendimi i atakuar i AL, është jo i drejtë dhe jo ligjor, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes fakte si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale dhe konsideron se kërkesa e tij nuk është parashkruar asht siç thekson pala kundërshtarë në vendimin e saj dhe pohon se ka punuar në këtë ndërmarrje që nga vitin 1992 deri në vitin 2014. Ankuesi pohon se ka parashtrua kërkesë për 20 % tek AKP me datë 11.04.2014, dhe i ka plotësuar kushtet komfor Udhëzimit Administrativ 2003/2 të lëshuar nga MPMS. I ka propozuar Gjykatës, që ankesën e tij ta aprovoj si të bazuar, dhe të prish vendimi e atakuar ose ta ndryshon dhe të aprovohet ankesa e tij. Ankuesi si dëshmi ka bashkangjitur në vendimin nr.707 të datë 18.03.1992, kur kishte themeluar marrëdhënie pune tek ndërmarr në fjalë.

meqë është ndërprerë parashkrimi me njoftimin për ndërprerjen e punësimit të lëshuara nga AKM me dt.31 janar 2008. Si dëshmi k bashkangjitur njoftimin për ndërprerje të punësimit N.SH të lëshuara nga AKM me dt. 31 janar 2008, autorizimin e avokatit për përfaqësim, regjistrin e pagës së fundit (shkurt 2007) dhe një Bilanc të suksesit të N.Sh-së.

Me 22 shkurt 2022, e paditura AKP, ka paraqitur kundërpërgjigje në përgjigjen e ankuesit dhe ka deklaruar se mbetet në tersi pranë mbrojtjes së paraqitur me herët duke theksuar se ankuesi vetëm ka përsëritur përditimet e tija dhe nuk ka paraqitur asgjë relevante që do e ndryshonte vendimin e AL.

Në lidhje me detajet tjera, gjykata i referohet shkresave të lëndës dhe parashtrësive të palëve.

Arsyetimi ligjor

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i N.SH. “K.B. Bujqësia”. Në këtë çështje, kontestuese ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit dhe mungesa e të provuarit me prova me të cilat do dëshmohej se N.SH. “K.B. Bujqësia” i ka mbetur borxh ankuesit pagat e papaguara nga marsi 2007 deri në janar 2008, në shumë prej 1,782.00 €. E paditura e ka kundërshtuar kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. Ankuesi e ka kundërshtuar një pretendim të tillë duke u bazuar në njoftimin mbi ndërprerjen e punësimit të dt.31 janar 2008, e për të cilën edhe gjykata konsideron se parashkrimi është ndërprerë pikërisht me këtë njoftim dhe se në rastin konkret nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Gjykata vlerëson se nuk është e mjaftueshëm vetëm ndërprerja e parashkrimit sepse në këtë lëndë e paditura e ka kontestuar edhe mungesën e të provuarit me prova duke u thirrur në neni 7 të LPK-së dhe në Ligjin për Dhomën e Posaçme, ndërsa ankuesi nuk ka bashkangjitur prova relevante me të cilat do dëshmohej se N.SH. “K.B. Bujqësia”, i ka mbetur borxh ankuesit pagat e papaguara nga marsi 2007 deri në janar 2008, në shumë prej 1,782.00 €.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese)”*, ndërsa pika 3 parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë”*.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Ankuesi edhe me ankesë para gjykatës nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se N.SH. “K.B. Bujqësia”, i ka mbetur borxh pagat e papaguara në shumë prej 1,782.00 €. Kopja e vendimit të atakuar të Autoritetit të Likuidimit, njoftimi për ndërprerje të punësimit në N.SH e lëshuar nga AKM me dt. 31 janar 2008, regjistri i pagës së fundit (shkurt 2007) dhe Bilanci i suksesit të N.Sh-së, nuk janë dëshmi me të cilat dëshmohej e N.Sh i ka mbetur borxh ankuesit.

Ankuesi edhe me përgjigjen ndaj mbrojtjes së të paditurës, ka dështuar që të dorëzojë prova relevante me të cilat do të dëshmohej se N.SH i ka mbetur borxh pagat e papaguara në shumë

prej 1,782.00 €, andaj Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë i bart shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi e ka paguar taksen gjyqësore për ankesë dhe nuk ngarkohet me shpenzime shtesë.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

G j y q t a r e

Ganimete Puka